

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 250 REP

NR. 74 KOL 11



**KONTRATË DHURIMI**  
**(Kuotash Kapitali)**

Sot më 10.02.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje noteres publike, Suzana JASHARI, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me zyrë në adresën rruga "Kont Uran" Nr 20, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me Kodit Civil, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), statutit të shoqërisë "Previsa" SHPK dhe vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë të datës 23 Janar 2018, me kushtet e mëposhtme:

**PALËT**

**Pala Dhuruese:**

**Perije Rexhepi**, e bija e Nurjet dhe Seniha, e datëlindjes 15.12.1959, lindur dhe banuese në Tiranë, në adresë rruga "Mine Peza", Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit nr. personal F96215200G, Administratore dhe Ortake e Vetme e Shoqëria "Previsa" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), më datë 29.02.1992, me Certifikatë Regjistrimit (NIPT) J61813035G, me seli në Tiranë, rruga "Mine Peza", nr. 162.

**Pala pranuese e Dhurimit:**

**Visar Rexhepi**, i biri i Petrit dhe Perije, i datëlindjes 28.03.1984, lindur në Prishtinë, dhe banues në Tiranë, në adresën rrugën "Mine Peza", Nr 162, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I40328089N

**Kushtet Paraprake**

- Shoqëria "Previsa" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), më datë 29.02.1992, me Certifikatë Regjistrimit (NIPT) J61813035G, me seli në Tiranë, rruga "Mine Peza", nr. 162, me kapital të regjistruar 60.000.000 (gjashtëdhjetë milion) lekë, me ortak të vetëm dhe administrator znj. Perije Rexhepi;
- Ortakja Perije Rexhepi ka shprehur vullnetin e saj në vendimin e datës 23 Janar 2018 që kuotat që ajo zotëron në shoqërinë "Previsa" SHPK, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë t'ia tranferojë nepermjet dhurimit djalit të saj Visar Rexhepi.

VISAR REXHEPI

## **II OBJEKTI**

Nëpërmjet kësaj kontrate dhuruesja Perije Rexhepi kuotat që ajo zotëron në shoqërinë "Previsa" SHPK, të cila përbëjnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, do t'ia dhurojë djalit të saj Visar Rexhepi. Dhuruesja deklaron se kuotat janë të lira dhe mbi to nuk ka të vendosur ndonjë barrë siguroese.

## **III PRANUESI I DHURIMIT**

Pranuesi i dhurimit Visar Rexhepi deklaron se e pranon dhurimin e bërë nga nëna e tij Perije Rexhepi, për pasurinë e përshkruar në Kushtet Paraprake dhe njëkohësisht objektin e kësaj kontrate.

## **IV KALIMI I PRONËSISË**

Pronësia mbi kuotat e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Previsa" SHPK, e cila përbën 100% të kapitalit të kësaj shoqërie, do të kalojë nga pala dhuruese Perije Rexhepi tek pala pranuese e dhurimit Visar Rexhepi pas depozitimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë.

Nga momenti i depozitimit të kontratës dhuruesja Perije Rexhepi humbet çdo të drejtë pronësie mbi kapitalin e zotëruar në shoqërinë "Previsa" SHPK dhe këto të drejta fitohen nga pranuesi i dhurimit Visar Rexhepi.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në zyrën e noterisë, një origjinal duhet të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), një origjinal duhet të depozitohet në selinë e shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noterja, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteria e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

**DHURUESI**  
**Perije REXHEPI**

Perije Rexhepi

**PRANUESI I DHURIMIT**  
**Visar REXHEPI**

VISAR REXHEPI

**NOTERE**  
**Suzana JASHARI**

Suzana Jashari

**VENDIM**  
**I MBLLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME (ORTAKUT TË VETËM)**  
**TË SHOQËRISË “PREVISA” SHPK**

Sot, me datë 23 Janar 2018, bazuar dhe në zbatim të statutit të shoqërisë dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), ortaku i vetëm i shoqërisë “Previsa” SHPK, znj. Perije Rexhepi, i mbledhur në selinë e shoqërisë, lidhur me çështjet e rendit të ditës:

- Marrjen e vendimit për dhurimin e kuotave të cilat përbëjnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “Previsa” SHPK.

Ortaku i Vetëm i shoqërisë “Previsa” SHPK shpreh vullenet e saj dhe :

**VENDOS**

1. Dhurimin e kuotave që ajo zotëron në shoqërinë “Previsa” SHPK, kuota të cilat përbëjnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë tek djali i saj Visar Rexhepi dhe largimin e ortakut Perije Rexhepi nga shoqëria.
2. Ortaku i Vetëm i jep të drejtë dhe kompetencë të plotë administratorit të shoqërisë për të vepruar pranë çdo autoriteti shtetëror si dhe çdo subjekti tjetër, me qëllim zbatimin e vendimit të marrë nga ortaku i vetëm.

**ORTAKU I VETËM**

**PERIJE REXHEPI**

*Perije Rexhepi*  
*Rexhepi*

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20180201122313182  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 01.02.2018  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 12:23:13PM  
Lloji i Kerkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-281-1229  
Referenca e Perdoriesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

PREVISA SH.P.K.

